

Plagoset një person në rrugën Klinë – Gjakovë, ishte duke udhëtuar me familjen e tij

LAJME

LAJMI I FUNDIT

lajmi.net

Më afër lexuesit.

03/08/2025 11:53

f

t

e

Një person është qëlluar me armë zjarri në rrugën Klinë – Gjakovë, në afërsi të fshatit Kramovik.

Ngjarja ka ndodhur rreth orës 01:00 të ditës së sotme.


Lidhur me rastin detaje për [lajmi.net](#), ka dhënë Sheremet Elezaj, zëdhënës i policisë për rajonin e Gjakovës.

Elezaj tha se viktimja kishte qenë duke udhëtuar me familjarët e tij.

Ai theksoi se rasti po hetohet si “Vrasje në tentativë”.

“Sot në orët e hershme të mëngjesit, është pranuar informata se një mashkull i moshës madhore është dërguar për trajtim mjekësor, pasi ishte qëlluar me armë zjarri. Ngjarja dyshohet të ketë ndodhur rreth orës 01:00, në rrugën Klinë–Gjakovë në afërsi të fshatit Kramovik. Sipas të dhënave fillestare, viktimja kishte qenë duke udhëtuar me familjarët e tij. Ne ndërkohë kishte dalë nga vetura me të cilën po udhëtonte dhe në afërsi të rrugës është qëlluar nga një drejtim ende i panjohur. Viktimja aktualisht është duke marrë trajtim mjekësor. Lidhur me rastin është njoftuar prokurori i shtetit dhe me vendim të tij është iniciuar rasti “Vrasje në tentativë”. Rasti është duke u hetuar nga njësitet kompetente policore”, deklaroi Elezaj.

Artikuj të ngjashëm



August 3, 2025

Vetmia tek adoleshentët: Një shqetësim global që ndihet edhe në Kosovë



August 3, 2025

Dodik thotë se Republika Sërpska do të hakmerret pas dënimit të...



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Brr. Zenel Salihu nr. 28, zyrrja nr.

RRJETET SOCIALE



Other Links

Fact-Checking Policy
Ethics Policy
Corrections Policy
Ownership & Funding Information
Editorial Team Information